



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/59

Datë: 21.01.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar, të nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej një milion euro (1,000,000,00 €) për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit në Komunitet të Republikës së Kosovës, si pasojë e vërshimeve të ndodhura në javën e parë të janarit të vitit 2021.
2. Autorizohet Ministria e Pushtetit Lokal (MPL) për caktimin e kriterëve për kompensim dhe për themelimin e Komisionit ndërministror që ka për detyrë verifikimin e vlerësimeve sipas pikës 3. të këtij vendimi, si dhe koordinimin e procesit të vlerësimeve dhe ndarjes së mjeteve buxhetore nëpër komuna.
3. Kompensimi i dëmeve bëhet sipas kërkesës së komunave, bazuar në vlerësimin e komisioneve komunale sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Pushtetit Lokal. Vlerësimet e tilla verifikohen dhe konfirmohen me raport nga Komisioni Ndërministror përkatës.
4. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve kapitale.
5. Mjetet sipas pikës 3. të këtij vendimi, ndahen bazuar në Raportin e Komisionit Ndërministror sipas pikës 2. të këtij vendimi, për secilën komunë përfituese të këtyre fondeve. Komisioni Ndërministror përcakton programin dhe nën-programin buxhetor dhe kategoritë adekuate të shpenzimeve.
6. Dëmet e shkaktuara në infrastrukturë publike do të kompensohen nga buxheti i komunës dhe i Ministrisë së Infrastrukturës (MI), bazuar në kërkesat e komunave dhe kriteret e përcaktuara nga ministria, nga ndarjet buxhetore sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2021.
7. Dëmet e shkaktuara në sektorin e bujqësisë do të kompensohen nga buxheti i komunës dhe i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), bazuar në kërkesat e komunave dhe kriteret e përcaktuara nga ministria, nga ndarjet buxhetore sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2021.

8. Nëse gjatë procesit të verifikimit të dëmeve, vlerësohet i nevojshëm krijimi i projekteve të reja kapitale, kjo duhet të bëhet me vendim të Qeverisë, në përputhje me nenin 29 të LMFPF dhe nenin 17. të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.
9. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
10. Udhëzohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Infrastrukturës që të trajtojnë kërkesat e Komunave në fushat e tyre të përgjegjësisë, brenda mundësive buxhetore, bazuar mbi kritere të qarta dhe përfaqësimit të ekuilibruar dhe barabartë.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/59

Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, në zbatim të vendimit nr. 06/58 të datës 14.01.2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej gjashtë milionë e pesëqind mijë euro (6,500,000 €), për subvencionimin e bizneseve aktive dhe të vetëpunësuarve, si vazhdimësi e vendimeve Nr. 10/33, i datës 28.09.2020, lidhur me pikën 1, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 14/34, i datës 07.10.2020 dhe vendimin Nr. 01/35 i datës 12.10.2020.
2. Subvencionimin e linjës së pagave apo çekut të pagave për bizneset aktive dhe të vetëpunësuarit, sipas kuotës së njëjtë, 290.06, dhe kriterëve të përcaktuar nga Komisioni ndër-ministror sipas pikës 7 të këtij vendimi dhe bazohet në kriteret e vendimit të Qeverisë Nr. 10/33, i datës 28.09.2020, lidhur me pikën 1, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 14/34, i datës 07.10.2020 dhe vendimin Nr. 01/35 i datës 12.10.2020, me përjashtimet si në vijim:
 - 2.1. Për bizneset e reja të regjistruara në tremujorin e fundit të vitit 2019, referenca për subvencionim do të bazohet në numrin e të punësuarve bazuar në deklaratën e tatimit të mbajtur në burim për muajin Korrik 2020, sipas legjislacionit në fuqi. Në mungesë të numrit të të punësuarve në Korrik 2020, për bazë do merret muaji Gusht 2020;
 - 2.2. Për bizneset aktive qe deklaratën tatimore nuk e kanë dorëzuar përmes sistemit EDI, kërkohen dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020;
 - 2.3. Për të vetëpunësuarit, pavarësisht nëse kanë apo jo linjë të pagave, referenca për subvencionim do të bazohet në numrin e të punësuarve bazuar në deklaratën e tatimit të mbajtur në burim për muajin Dhjetor 2019. Përjashtimisht, nëse biznesi aktiv i vetëpunësuar është regjistruar në tremujorin e fundit të vitit 2020, apo gjatë periudhës Janar - Gusht 2020, subvencionimi do të bazohet në numrin e të punësuarve të deklaruar në sistemin e ATK-së (EDI), për muajin Korrik 2020, përkatësisht Gusht, për biznset e regjistruara në Gusht 2020;

- 2.4. Institucionet mikrofinanciare dhe jo-bankare, të cilat nuk merren me aktivitetin e kredi-dhënies apo lizingut, nuk përjashtohen nga pika 1.1.2 e vendimit Nr. 10/33, dhe përfitojnë bazuar në kushtet e përcaktuara me këtë vendim.
3. Asnjë biznes që ka përfituar nga subvencionimi sipas pikës 1 të vendimit Nr. 10/33, i datës 28.09.2020, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 14/34, i datës 07.10.2020 dhe vendimin Nr. 01/35 i datës 12.10.2020, nuk mund të përfitojnë nga ky vendim.
4. Shuma e subvencionimit bazohet në numrin e të punësuarve të deklaruar formalisht në sistemet e ATK-së (EDI), dhe të dorëzuara në kohe me dëshmi bankare, para datës 28.09.2020, në formatin e lejuar nga ATK.
5. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi, merren nga nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF) me kod 29300, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere. Mjetet ndahen në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me kod 213, në nën-programin Ndërmarrësia me kod 49400, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, dhe alokohen vetëm pas konfirmimit të listave nga Komisioni përkatës ndër-ministror bazuar në kuotën për një të punësuar, deri në masën e subvencionimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
6. Në rast se pas zbatimit të këtij vendimi mbeten mjete të pa-alokuara dhe pashfrytëzuara, të njëjtat mund të përdoren për vazhdimin e ekzekutimit të ri-pagesave të nga e njëjta masë, të cilat nuk janë realizuar gjatë vitit 2020, për shkak të mungesës së llogarive bankare apo për shkak të dështimit të transferit për shkak të dhënave bankare të pasakta të përfituesve të deklaruar në sistemin e ATK-së.
7. Të gjitha pikat tjera që nuk janë ndryshuar përmes këtij vendimi mbeten sipas pikës 1 të vendimit bazë Nr. 10/33, dhe vendimit Nr. 14/34, si dhe vendimin Nr. 01/35 i datës 12.10.2020, si dhe kriteret e përcaktuara nga Komisioni Ndër-ministror, i themeluar me vendim të Ministres së Financave Nr. 99/2020, datë 29.09.2020, për aq sa nuk bien ndesh me këtë vendim.
8. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe të gjitha ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Gjatë procesit të ekzekutimit të pakos 60 milionë euro, është vërejtur se disa segmente, përkatësisht biznese aktive të regjistruar në tremujorin e fundit të vitit 2019, nuk kanë pasur aktivitet dhe as nuk kanë deklaruar në Dhjetor 2019, por që kanë qenë aktive gjatë vitit 2020, dhe për rrjedhojë kanë qenë të përjashtuara nga subvencionimi.

Gjithashtu, të vetëpunësuarit që nuk kanë linjë të pagave, si bizneset tjera, për shkak të natyrës së punës (pronari, vetë i punësuar), kanë mbetur jashtë pakos së parë.

Institucionet mikrofinanciare dhe jo bankare, të licencuara nga BQK, që nuk merren me kredi-dhënie dhe as lizing janë konsideruar si treg i rregulluar, dhe për rrjedhojë, kanë mbetur jashtë subvencionimit të pakos së parë. Lista e institucioneve të licencuara nga BQK, që nuk merren me kredi-dhënie dhe as lizing, përfshihen përmes këtij vendimi në subvencionim.

Të gjitha kriteret tjera vlejné sikur nga vendimi bazë 10/33, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 14/34 si dhe vendimin Nr. 01/35 i datës 12.10.2020, në përputhje me ndryshimet në këtë vendim.

Për shkak të përfundimit të vitit fiskal, buxheti i kësaj pakoje si dhe ekzekutimi i saj, behet bazuar ne disponueshmerinë e fondeve dhe ligjin e buxhetit për vitin 2021.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Simjali



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, Paragrafi 1, i Ligjit Nr.07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr 07/2017, nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr 09/2011, në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, vendim të Qeverisë nr.01/23, të datës 13.08.2020, vendimin e Qeverisë nr. 06/58 datë 14.01.2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Planifikimi dhe Zbatimi i programit për rimëkëmbjen ekonomike Faza II-Masa 4 - Mbështetje Financiare për Projektet dhe iniciativat që synojnë përmisimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi.
2. Obligohet Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të zbatoj dhe monitoroj planin sipas pikës një të këtij vendimi .
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/59

Datë: 21.01.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësisë së Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive , e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2020, neni 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, si dhe bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/58 të datës 14.01.2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 21 janar 2021 merr këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në vlerë prej 21,000,000.00 € (njëzet e një milion euro), për zbatimin e masës nr.16, pika 1.16.1 dhe pika 1.16.2 sipas vendimit Nr.06/58 të datës 14.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në kriteret e poshtë shënuara.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi merren nga nenprogrami-programi i rimëkëmbjes ekonomike (MF) me kod buxhetor 29300, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Mjetet ndahen në organizatën buxhetore Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kod 209:
 - 3.1. Për dyfishimin e pagesës së shumës së ndihmës sociale, bazuar në numrin e familjeve përfituese të muajit përkatës dhe anëtarëve të familjes për të gjithë përfituesit e ndihmave sociale në vlerë prej shtatë milion e pesëqind mijë euro (7,500,000 €) për muajt Janar-Mars 2021.
 - 3.2. Pagesën e shtesës në vlerë prej 30 € (tridhjetë euro) për skemat pensionale dhe sociale që marrin pagesa mujore deri në 100 € (njëqind euro), në vlerë prej 13,500,000 € (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro), për muajt Janar-Mars 2021.
4. Shpërndarja dhe alokimi i mjeteve buxhetore sipas pikës 3 të këtij vendimi bëhet nëpër nën-programet me kode organizative dhe kategori të shpenzimeve si në vijim:

- 4.1. Dyfishimi i pagesës së shumës së ndihmës sociale, sipas pikës 3.1 të këtij vendimi në kuadër të nën-programit me kodin organizativ 00500-Ndihmat Sociale në kategorinë e shpenzimeve subvencionet dhe transferet shuma prej 7,500,000 euro.
- 4.2. Për pagesën e shtesës për të gjithë përfituesit e skemës së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar nga mosha 1-18 vjeç dhe përfituesit e strehimit familjar të brendshëm, ndahen 300,000.00 € (treqind mijë euro), në kuadër të nën-programit me kodin organizativ 00600 - Shërbimet Sociale, në kategorinë e shpenzimeve subvencionet dhe transferet.
- 4.3. Për pagesën e shtesës për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve bazike në vlerë prej 11,180,800.00 € (njëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjete mijë e tetëqind euro), në kuadër të nën-programi me kodin organizativ 00100-Pensionet Bazike në kategorinë e shpenzimeve subvencionet dhe transferet.
- 4.4. Për pagesën e shtesës për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve të aftësisë së kufizuar (PPAK) në vlerë prej 1,690,000.00 € (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë euro), në kuadër të nën-programit me kodin organizativ 00200-Pensionet e Aftësisë së Kufizuar (PPAK) në kategorinë e shpenzimeve subvencionet dhe transferet.
- 4.5. Për pagesën e shtesës për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve familjare në vlerë prej 322,000 € (treqind e njëzet e dy mijë euro), në kuadër të nën-programit me kodin organizativ 02900-Pensionet Familjare në kategorinë e shpenzimeve subvencionet dhe transferet.
- 4.6. Për pagesën e shtesës për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve invalidore të punës në vlerë prej 7,200.00 (shtatë mijë e dyqind euro), në kuadër të nën-programit me kodin organizativ 03000-Pensionet invalidore te punës në kategorinë e shpenzimeve subvencionet dhe transferet.
5. Dyfishimi i pagesës së shumës së ndihmës sociale si dhe shtesa prej 30 euro për skemat pensionale dhe sociale që marrin pagesa mujore deri në 100 € (njëqind euro), realizohet së bashku me pagesën e rregullt për muajt Janar, Shkurt dhe Mars 2021.
6. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrave (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/59

Datë: 21.01.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, nenin 4 të Rregullores nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2020, në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në zbatim të masës 6 të vendimit 05/58 datë 14.01.2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë deri në 1,600,000 € (një milion e gjashtëqind mijë euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", për organizatën buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, nën-programi "Shërbimet administrative" me kod 30000, për zyrtarët aktiv policorë për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt në zbatimin e detyrave në menaxhimin e pandemisë COVID-19.
2. Mjetet për zbatimin e këtij vendimi ndahen nga nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF)" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Paga dhe shtesa".
3. Shuma e mjeteve shtesë financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndahet për pagesën e shtesës mbi pagë për zyrtarët policorë, në shumën prej 100 (një qind) euro në muaj për secilin muaj aktiv: Janar, Shkurt dhe Mars të vitit 2021.
4. Lista e përfituesve sipas pikës 3 të këtij vendimi aprovet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Ministri i Punëve të Brendshme, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës (MF), në përputhje me kriteret e caktuara në këtë vendim.
5. Shtesa mbi pagë sipas pikës 3 të këtij vendimi, realizohet së bashku me pagën e muajit përkatës (Janar, Shkurt dhe Mars), përmes Sistemit të Pagave.
6. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Ministria e Financave dhe Thesari për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Simjali



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/59

Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në zbatim të masës 6 të vendimit 05/58 date 14.01.2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Për shkak të pandemisë shtesat mujore mbi pagën bazë për personelin aktiv në vend të punës për muajin e plotë për të cilin merret shtesa në institucione shëndetësore publike përmes listës së pagave në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID-19 për muajt: Janar, Shkurt dhe Mars të vitit 2021, në shumë deri në tetë milionë euro (8,000,000 €), me kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Kategoria I – mjekë, iu ndahet shtesa prej 250 euro në muaj;
 - 1.2. Kategoria II – infermierë, iu ndahet shtesa prej 150 euro në muaj; dhe
 - 1.3. Kategoria III – stafi mbështetës – teknik, iu ndahet shtesa prej 100 euro në muaj.
2. Mjetet për zbatimin e këtij vendimi ndahen nga nën-programi “Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF)” me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “Paga dhe shtesa” dhe ndahen tek secila organizatë buxhetore që punëson profesionistë shëndetësor sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Organizatat Buxhetore (OB) janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovojnë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të OB-së listat e personelit të tyre shëndetësor dhe mbështetës me kategorizimin e përcaktuar më lartë dhe të njëjtat përcillen në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilat pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij vendimi dhe udhëzimeve nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë me shkresë të veçantë dërgohen në Thesar.
4. Pas pranimit të listave përfundimtare sipas pikës 3, autorizohet Ministria e Financave që të bëjë ndarjen buxhetore për tre muaj tek secila OB, në kategorinë “paga dhe shtesa”, bazuar në shumën e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa alokimi i mjeteve bëhet çdo muaj, bazuar në çekun e përlogaritur të pagave së bashku me shtesat përkatëse.
5. Pagesa e shtesës mbi pagë realizohet përmes Sistemit të Pagave, në baza mujore, me pagën e muajit përkatës. Në rast se listat përfundimtare sipas pikës 3 të këtij vendimi procedohen në Thesar me vonesë, jashtë afatit për procedimin e ndryshimeve në Sistemin e Pagave, të njëjtat shtesa procedohen me pagën vijuese, si pagesë retroaktive e shtesës.

6. Obligohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Simjali



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/59

Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 54, paragrafet 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Betim Reçica, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, transferohet në pozitën Kryeshf në Agjencinë Kosovare të Standardizimit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
2. Transferimi i z. Reçica sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrave dhe përgjegjësisë në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda mandatit të tij të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 10/95, të datës 26.03.2019.
3. Obligohet Ministria e Infrastrukturës – Agjencia Kosovare e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 54, paragrafet 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arton Berisha, Sekretar i Përgjithshëm në ish Ministrinë e Administratës Publike, transferohet në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.
2. Transferimi i z. Berisha sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrave dhe përgjegjësive në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda mandatit të tij të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/89, të datës 12.02.2019.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme – Akademia e Kosovës për Siguri Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 54, paragrafet 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Kushtrim Cukaj, Sekretar i Përgjithshëm në ish Ministrinë e Integriteteve Evropiane, transferohet në pozitën Kryeshf i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Transferimi i z. Cukaj, sipas pikës 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrave dhe përgjegjësisë në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda mandatit të tij të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 18/64, të datës 11.09.2018.
3. Obligohet Ministria e Drejtësisë - Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 54, paragrafet 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Hajriz Koca, Sekretar i Përgjithshëm në ish Ministrinë e Inovacionit, transferohet në pozitën Kryeshef në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
2. Transferimi i z. Koca sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrave dhe përgjegjësi në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda mandatit të tij të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 18/81, të datës 24.12.2018.
3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 42, paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ekrem Kastrati i vazhdohet mandati i Kryeinspektorit të Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për një kohëzgjatje 4 vjeçare.
2. Z. Kastrati i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/59
Datë: 21.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 42 dhe 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Fatos Qerimi, i vazhdohet mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit edhe për katër (4) vite.
2. Afati prej katër (4) viteve i paraparë në paragrafin 1 të këtij vendimi fillon të zbatohet nga data 10.03.2021.
3. Z. Fatos Qerimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë